

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-42/12

**Prishtinë,
5 mars 2013**

Në çështjen juridike të

B.S

Paraqitësi i kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me kërkesën e paraqitësit të kërkesës kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK /D/A/29/2008 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA14194), e datës 19 dhjetor 2008, pas shqyrtimit të mbajtur më 5 mars 2013, mori këtë

AKTVENDIM

**Shpallet jokompetente lidhur me këtë çështje juridike, dhe i kthehet
KKPK-ës. Kërkesa e paraqitësit të kërkesës nuk mund të
interpretohet si ankesë.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 21 shtator 2006, B.S ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin e një pronë që ndodhet në Pejë, Jablanica/Ljesanska. Formulari i kërkesave që është nënshkruar nga paraqitësi i kërkesës përmbante informatat si në vijim: ngastra Nr. 40 me sipërfaqe prej 9 ari dhe 82 m². Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA14194.

Fleta poseduese Nr. 24, e datës 7 nëntor 2007, megjithatë, dëshmon se ngastra nr. 40 përbëhet nga tri pjesë: një shtëpi prej 54 m², oborr prej 5 ari dhe një livadh prej 9 ari dhe 82 m².

Me vendimin KKKP/D/A/29/2008 të datës 19 dhjetor 2008, e specifikuar me Vendimin e vërtetuar të datës 17 mars 2009, KKKP-ja aprovoi kërkesën për ri-posedim të “ngastrës numër 40, me sipërfaqe prej 0 He, 9 Ari, 82m²”.

Pasi që paraqitësi i kërkesës kishte autorizuar Qendrën Ballkanike për Migracion dhe Aktivitete Humanitare (QMAH) që të pranojë çdo vendim dhe korrespondenca tjera (autorizim i kufizuar i datës 26 tetor 2011), vendimi i KKKP-së i është dërguar QMAH-së më 9 nëntor 2011.

Më 31 janar 2012, paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesën në vijim:

*“Agjencia Kosovare e Pronës
Sekretariati për mbrojtjen e pronës private, Prishtinë*

Në vendimin tuaj AKP 14194 – sipas fletës poseduese nr. 24, komuna e Pejës, ZK Jablanica (Ljesavska) lidhur me shkresën time të datës 12.05.2011 ju keni njohur të drejtën time pronësore, por vetëm për njërën pjesë të ngastrës nr. 40, me sipërfaqe prej 9 ari dhe 82 m².

Pasi që në vendimin e cekur ju nuk keni përfshirë tërë sipërfaqen e ngastrës numër 40, unë kërkoj nga ju që ta njihni të drejtën time mbi pjesën e mbetur të pronës për ngastrën 40, sipas fletës poseduese nr. 24 si vijon:

- Pjesa e ngastrës 40, sipërfaqe prej 00 ha 00 ari dhe 54 m² – tokë, shtëpi, dhe*
- Pjesë e ngastrës 40, sipërfaqe prej 00 ha 05 ari dhe 00 m² – tokë, oborr.”*

Më tej në letrën e tij ai ia përkujton AKP-së disa kërkesa lidhur me lëndët tjera pranë AKP-së, posaçërisht kërkesat për ta marrë përsipër administrimin e disa pronave.

AKP-ja interpretoi këtë kërkesë si ankesë dhe ia dërgoji Kolegjit të Apelit të AKP-së. Në urdhrin e Kolegjit të datës 21 janar 2013, KKKP shpjegoi se meqë paraqitësi i kërkesës kishte kërkuar vetëm 9 ari dhe 82 m² të ngastrës, vendimi i vitit 2008 me të drejtë i referohej vetëm kësaj pjesë të ngastrës.

Arsyetimi ligjor

Lënda duhet të kthehet prapa në KKPK pa ndonjë vendim mbi ankesën pasi që kërkesa e paraqitësit të kërkesës nuk përmban ankesë të tillë. Paraqitësi i kërkesës nuk dëshiron ende që Kolegji i Apelit të AKP-së të merr vendim, por e kufizon veten në (ndër tjerash) një kërkesë drejtuar Agjencisë Kosovare të Pronave që ta zgjerojë vendimin e vet për të përfshirë pjesët tjera të ngastrës.

Ky interpretim i kërkesës së paraqitësit të kërkesës fillimisht rezulton nga formulimi i kërkesës: Paraqitësi i kërkesës nuk e përdor fjalën “ankesë” sikurse do të pritej nëse do të dëshironte që të paraqiste një ankesë (e cila do të shkonte me shpenzime). Për më tepër, paraqitësi i kërkesës nuk emërton ndonjërin prej arsyeve për shkak të së cilave një vendim mund të ankimohet (zbatim i gabuar i ligjit, vërtetim i gabuar i fakteve). Paraqitësi i kërkesës gjithashtu nuk kërkon nga gjykata që ta ndryshojë vendimin, por që Agjencia Kosovare e Pronës (“vendimi juaj”, “ju”) ta ndryshojë vendimin. Në fund, në këtë dokument paraqitësi i kërkesës përfshin pretendimet nga kërkesat tjera, ndër to kërkesat që të merr përsipër administrimin e pronave të veta. Këto kërkesa nuk mund të realizohen nga gjykata, por vetëm nga AKP-ja.

Gjykata dëshiron të shtojë se kërkesa e paraqitësit të kërkesës nuk ka mbërritur në AKP brenda periudhës prej 30 ditësh pas dërgesës së vendimit, sikurse parashihet me ligj për ankesat (Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Fakti se paraqitësi i kërkesës nuk e ka dërguar kërkesën e tij brenda periudhës së paraparë për ankesa mund të kuptohet gjithashtu si një shenjë se paraqitësi i kërkesës nuk ka dashur të paraqesë ankesë (e cila do të ishte e papranueshme).

Nga e gjithë kjo, rrjedh se paraqitësi i kërkesës nuk ka dashur të ankohet kundër vendimit, por vetëm të kërkojë veprime shtesë nga AKP/KKPK. Pa një ankesë, megjithatë, gjykata nuk mund të vendos mbi vendimin e KKPK-së.

AKP/KKPK do të duhet të reagojnë ndaj kërkesave të paraqitësit të kërkesës dhe në veçanti të vendosin rreth kërkesës lidhur me pjesët e ngastrës nr. 40 për të cilën KKPK-ja nuk ka vendosur.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it